



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

## NJOFTIM PËR SHTYP

**Rasti:** Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë SK Wind GmbH & Co.KG nga shoqëria Statkraft Germany GmbH dhe shoqëria Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.378 Prot., i AK, datë 25.08.2021 “Njoftim përqendrimi: Blerja e SK Wind GmbH & Co.KG nga Statkraft Germany GmbH dhe Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë SK Wind GmbH & Co.KG nga shoqëria Statkraft Germany GmbH dhe shoqëria Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH.

Referuar “Marrëveshjes së Shitblerjes” të lidhur më datë 20 gusht 2021, palët janë:

### **Pala Blerëse:**

**Blerësi 1.** Statkraft Germany GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionin gjerman, me objekt veprimtarie: Veprimtaria holding, blerja, administrimi dhe shitja e aksioneve në shoqëri të tjera dhe kryerja e të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura.

**Blerësi 2.** Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionin gjerman, me objekt veprimtarie: Blerja, administrimi dhe menaxhimi i shoqërive holding.

Shoqëria Statkraft Germany GmbH dhe shoqëria Statkraft Holding Wind & Solar Deutschland GmbH janë pjesë e Statkraft Group.

### **Pala shitëse:**

**Shitësi 1:** Breeze Three Energy GmbH & Co. KG, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti në industrinë e gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

**Shitësi 2:** Breeze Three GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas legjislacionin gjerman.

**Shoqëria Target:** SK Wind GmbH & Co.KG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionin gjerman, me objekt veprimtarie: zotërimin e një portofoli me ferma të gjenerimit të energjisë nga era.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**